



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA**  
**SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF**

**KOSOVA**

Agj.nr. 32/12

15.01.2013

Prishtinë

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 15.1.2013, miratoi këtë :

**Mendim juridik**

1. Të gjitha lëndët që, konform nenit 36 të Ligjit për Shpronësimin, i janë adresuar Gjykatës Supreme dhe ishin regjistruar në këtë Gjykatë si konflikte administrative, duhet t'u dorëzohen gjykatave themelore - Departamentit të përgjithshëm, në territorin e të cilave ndodhet palujatshmëria që është objekt shpronësimi, me qëllim të caktimit të kompensimit të drejt, konform nenit 216 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore .

2. Të gjitha kontestet e kësaj natyre që do të adresohen në gjykata në të ardhmen, pavarësisht se si e kanë emërtuar palët parashtresën – ankesë apo propozim, do të konsiderohen si propozim për caktimin e kompensimit të drejtë dhe do të regjistrohen si lëndë civile të ndryshme (CN) te gjykata themelore në territorin e së cilës ndodhet palujatshmëria,

## A r s y e t i m

Në nenin 36 të Ligji për Shpronësimin e pronës së paluajtshme ishte ndërtuar një kompetencë ekskluzive për Gjykatën Supreme, ashtu që në çështjet e shpronësimit, kur ky është bërë për interes të Qeverisë së Kosovës dhe ka mospajtim rreth çmimit që ka caktuar organit shqyrtues, pala kishte të drejtë që t'i drejtohet me ankesë Gjykatës Supreme për caktimin e kompensimit të drejtë (do të duhej të ishte me propozim, por ligji ka përdorur shprehjen ankesë). Ky lloj kontesti nuk kishte fare natyrën e konfliktit administrative, por ishte kontest i pastër gjyqësor, mirëpo meqë Gjykata Supreme kishte juridiksion fillestar (gjykatë e shkallës së parë) vetëm në konfliktet administrative, u detyruar që këto lëndë t'i regjistrojë si konflikte administrative, për shkak të pasojave që kishte prodhuar një dispozitë ligjore jokompatibël dhe jo e natyrshme me detyrat dhe rolin që ka Gjykata Supreme, si autoriteti më i lartë në hierarkinë gjyqësore .

Tani, me fillimin e aplikimit të Ligjit për Gjykatat, si ligj special, dispozita e nenit 36 është shfuqizuar në mënyrë shprehimore, ngase sipas nenit 39 të këtij Ligji, të gjitha lëndët të cilat deri më 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme dhe nuk janë zgjidhur me vendim të formës së prerë deri më 1.1.2013, trajtohen si lëndë të gjykatës themelore që ka juridiksion territorial.

Meqenëse me këto ndryshime tani kompensimin e drejt për tokën e shpronësuar nuk e bën Gjykata Supreme, por gjykata themelore, ndërsa kompensimi i drejtë është çështje e pastër gjyqësore, atëherë të gjitha këto lëndë që janë adresuar gjer më tani në Gjykatën Supreme, duhet t'u kalohen gjykatave themelore –Departamentit të përgjithshëm, në territorin e të cilave ndodhet pasuria e paluajtshme, për të cilën gjykatat në procedurë jokontestimore, në përputhje me neni 216 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, do të caktojnë kompensimin e drejtë duke i aplikuar në mënyrë analoge edhe dispozitat e tjera të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me kompetencën e Gjykatës Supreme.

Shpërndarje e këtillë e lëndëve do të jetë më e favorshme për palët, (ato do t'u shmangen shpenzimeve të panevojshme, do t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike, do të respektohen afatet e vendosjes), por kjo, po ashtu, do të jetë shumë më funksionale edhe për gjykatat.

Në dispozitat e nenit 216 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, nr.03/L-007, thuhet: “Nëse pjesëmarrësit në procedurën e eksproprijimit (shpronësimit) nuk arrijnë marrëveshje për kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar (shpronësuar) brenda afatit prej dy muajsh nga dita kur aktvendimi për eksproprijimin (shpronësimin) ka marrë formën e prerë, organi kompetent administrativ ia dërgon aktvendimin e formës së prerë, me të gjitha shkresat dhe provat për pagimin e shumës së ofruar të kompensimit pronarit ose për depozitimin e saj, **gjykatës në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria e eksproprijuar (shpronësuar)**, me qëllim të caktimit të kompensimit.

*Kryetari i Gjykatës,*

*Dr.sc. Fejzullah Hasani*

